



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 419/5 prot.

Tiranë, më 17.10.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 696, të datës 11.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Marsida Frashëri
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 3.10.2023, është njoftuar vendimi përfundimtar nr. 696, datë 11.9.2023, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër.

Së bashku me vendimin përfundimtar, si pjesë e akteve në dosje, Komisioni ka përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe *vendimin e ndërmjetëm* nr. 6 të Komisionit, nr. 577 akti, datë 13.5.2022, me anë të cilit ka vendosur: [...] *pezullimin nga detyra të znj. Marsida Frashëri, për një periudhë njëvjeçare me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës* [...].

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, si përfaqësues i interesit publik, neni F i aneksit të Kushtetutës dhe neni 63, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin përfundimtar të marrë nga Komisioni për subjektet e rivlerësimit, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 696, të datës 11.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër. Referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim referuar si GPPP), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Marsida Frashëri¹”, ka referuar për subjektin se:

- i. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e saj;
- iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite;
- iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit,² i ka referuar Komisionit: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës”.

2.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, znj. Marsida Frashëri.

3. Përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** [...] Trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të saktë në përputhje me ligjin, ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe nuk gjendet në situatë konflikti interesi sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].

¹ Raporti me nr. *** prot., datë **.10.2019, i ILDKPI-së.

² Shkresë nr.*** prot., datë **.10.2017, e DSIK-së (Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. **, datë **.1.2021.

3.2 **Për kontrollin e figurës.** [...] *Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

3.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** [...] *trupi gjykues konstatoi se subjekti ka shfaqur në mënyrë të përsëritur vonesa në trajtimin dhe përfundimin e çështjeve objekt shqyrtimi, në vazhdimësi gjatë ushtrimit të detyrës së saj si prokurore, duke krijuar rrethana me efekt negativ në rezultatet e vlerësimit profesional të saj...Trupi gjykues i Komisionit u mbledh në dhomë këshillimi në datën 10.5.2022 dhe vlerësoi në tërësi problematikat e konstatuara, të cilat konsistonin në mangësi vazhduese ndër vite, por në një normë të pranueshme, që nuk mund të sillnin pasojën më radikale të shkarkimit nga detyra, duke konsideruar ngarkesën në total të punës së saj dhe çështjet e trajtuara prej saj gjatë ushtrimit të detyrës... Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. **, datë **.7.2023, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, ka arritur rezultate të mira, duke tejkaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit [...].*

4. **Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, nenit 59, pika 1, dhe të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, në momentin procedural të njoftimit të vendimit të Komisionit, sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet përfundimtare të dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij, në të cilën janë arsyetuar në mënyrë të plotë konkluzionet dhe qëndrimi i Komisionit për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. Sa më sipër, Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit përfundimtar nr. 696, datë 11.9.2023, çmon se ato përmbajnë shkaqe ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar nr. 696/2023, të Komisionit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, në tërësinë e tij.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A Për vlerësimin e aftësive profesionale

9. Rezulton se hetimi i Komisionit, lidhur me kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, ka administruar raportin për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

10. Nga aktet e administruara në dosje, përvoja profesionale në 10 vitet e fundit, e subjektit të rivlerësimit, sipas të dhënave të deklaruara në rubrikën B të formularit dhe *Raportit të aftësive profesionale*, hartuar nga KLP-ja, rezulton ndër të tjera si vijon:

- (i) *Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezulton se subjektit të rivlerësimit, me urdhrin nr. **, datë **.3.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, i është dhënë masa disiplinore “Kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të drejtësisë”, duke kryer detyrën e Oficerit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga data **.3.2014 deri në datën **.9.2014³. Komisioni ka çmuar se vlerësimi i këtij rasti (çështjet e trajtuara gjatë kontrollit) do të vlerësohen në vijimësi me veprimtarinë e saj të mëtejshme gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit.*
- (ii) *Me vendimin nr. **, datë **.2.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm, rezulton se është filluar hetim disiplinor për prokuroren Marsida Frashëri, pas akteve dhe informacionit të dërguar nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në përfundim të trajtimit të këtij rasti, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka mbajtur në zyrën e saj fashikuj hetimorë, të cilët ishin në proces apo për të cilët nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim hetimor, duke treguar mungesë të theksuar të aftësive për administrimin e dosjeve gjyqësore, duke shmangur ngarkesën në punë, neglizhencë të paarsyeshme për zgjidhjen e çështjeve, duke shmangur rrethana që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit të saj.*
- (iii) *Me vendimin nr. ***, datë **.7.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm, është filluar hetimi disiplinor për prokuroren Marsida Frashëri, pas akteve dhe informacionit të dërguar nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ka rezultuar se Drejtuesi i Prokurorisë kishte përjashtuar nga shorti procedimet penale në hetim dhe*

³ Komisioni ka administruar aktet nga Prokuroria e Përgjithshme dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi në përfundim, lidhur me këto verifikime, duket se: [...] a) *Subjekti ka kryer shkelle të shumta dhe të ndryshme ligjore, ku në disa procedime penale të ndjekura prej saj është vënë re neglizhencë e pajustificuar në fazën e regjistrimit të procedimit penal, duke mospërmbushur detyrimet e parashikuara në nenin 287/1 të KPRP-së dhe të udhëzimit nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”;* b) *Subjekti nuk ka kryer në plotshmëri dhe vijueshmëri veprimet e domosdoshme hetimore paraprake, duke zvarritur në mënyrë të pajustificuar hetimet paraprake të procedimeve dhe duke treguar neglizhencë të pajustificuar për të marrë vendim përfundimtar [...].*

gjkim që ndiqeshin nga prokurori ***.***, pasi ai ishte emëruar anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në përfundim të verifikimeve nga dokumentacioni i administruar duket se subjekti i rivlerësimit, Marsida Frashëri, pa arsye, nuk ka pranuar të marrë në dorëzim materialet hetimore, duke mosrespektuar udhëzimin nr. **, datë **.12.2016, të sipërcituar.

11. Komisioni, pasi i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për sa ka konstatuar, ka administruar prapësimet e subjektit të rivlerësimit, në përfundim, ka marrë vendimin e ndërmjetëm nr. 6, nr. 577 akti, datë 13.5.2022, ndër të tjera, duke arsyetuar se: [...] *Trupi gjykues i Komisionit...arrin në përfundimin se prokurorja Marsida Frashëri, në mënyrë të vazhduar, pavarësisht tërheqjes së vëmendjes apo marrjes së masës disiplinore, ka vijuar në të njëjtën mënyrë të ushtrijë funksionin me mangësi në aspektin profesional. Trupi gjykues i Komisionit, duke çmuar në tërësi problematikat e konstatuara, duke qenë se këto mangësi rezultuan të vazhduara, ndër vite, por në një normë të pranueshme për të mos sjellë pasojën më radikale të shkarkimit nga detyra në raport edhe me ngarkesën në total të punës së saj dhe çështjet e trajtuara, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e plotësimit të këtyre mangësive nëpërmjet një programi trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës [...].*

12. Komisioneri Publik, në analizë të akteve në dosje, rezultateve të hetimit, si dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.2/2017⁴, si dhe jurisprudencën e Kolegjit, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe çmon se në kontrollin e aftësisë profesionale, subjekti i rivlerësimit nuk e ka kaluar nivelin kualifikues për konfirmimin e saj në detyrë dhe se subjekti i rivlerësimit, me veprimet/mosveprimet e saj, ka cenuar rëndë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke u gjendur në kushtet që mangësitë e evidentuara nuk mund të plotësohen, as nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, siç ka vendosur me vendim të ndërmjetëm Komisioni.

13. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, në vendimin përfundimtar nr. 696/2023, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë në asnjë fazë të hetimit administrativ shpjegime bindëse mbi shkeljet e evidentuara në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, gjetje të cilat duhet të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, për sa në vijim:

14. *Lidhur me hetimin disiplinor, nr. **, datë **.2.2019, të Prokurorisë së Përgjithshme*

15. Prokurori i Përgjithshëm, pasi është njohur me informacionin⁵ e Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me datë **.2.2019, ka marrë vendimin nr. **, “Për fillimin e hetimit disiplinor”, ndaj prokurorit Marsida Frashëri.⁶

16. Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër ka nxjerrë urdhrin “Për ngritjen e Grupit të Punës”, nr. **, datë **.9.2018, me objekt: “hapjen e zyrës së prokurores Marsida Frashëri dhe inventarizimin e akteve që ndodheshin në të”, për shkak se

⁴ Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, në paragrafin 54 të tij, ndër të tjera, citohet se në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë se: [...] Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)[...].

⁵ Përcjellë me shkresën nr.*** prot., datë **.10.2018.

⁶ Prokuroria e Përgjithshme, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, nr. ***, datë **.2.2022, ka përcjellë, me shkresën nr. *** prot., datë **.3.2022, dokumentacionin lidhur me hetimin disiplinor të prokurores Marsida Frashëri.

prokurorja ishte caktuar përkohësisht në Prokurorinë e Përgjithshme si pjesë e grupit mbështetës për përgatitjen e vlerësimeve profesionale të prokurorëve [...] por nuk kishte kryer dorëzimin e materialeve që ndiqeshin prej saj [...].

17. Nga grupi punës, pas hapjes së zyrës, janë konstatuar: (i) kallëzime penale, (ii) procedime penale, (iii) akt-ekspertime, (iv) përgjigje letër-porosit dhe (v) prova të ndryshme materiale, të cilat i përkisnin periudhës 2010 – 2017.

18. Këto akte procedurale ishin mbajtur të mbyllura në zyrën e subjektit të rivlerësimit deri në momentin e konstatimit nga grupi i punës. Nga verifikimi në regjistrin elektronik ka rezultuar se kallëzimeve/procedimeve penale nuk u ishte dhënë zgjidhje ligjore.

19. Prokurori i ngarkuar për fillimin e hetimit disiplinor, më datë **.4.2019, ka hartuar “Raportin mbi mbylljen e hetimit disiplinor në ngarkim të prokurorës pranë Gjykatës së Shkallës së parë, Shkodër, znj. Marsida Frashëri” (në vijim Raporti).

19.1.1 Si bazë për fillimin e këtij hetimi disiplinor, sikundër është pasqyruar dhe në vendimin e Prokurorit të Përgjithshëm, datë **.4.2019, kanë shërbyer faktet, sipas të cilave, [...] prokurorja Marsida Frashëri, në mënyrë të përsëritur dhe sistematike, ka vepruar në kundërshtim me nenin 291/1, 32, 324, të K. Pr. Penale, i ndryshuar, për rastet kur ka mbajtur në dorë për vite të tëra, pa veprime procedurale, materialet e kallëzimeve apo procedimeve penale që kanë regjistruar pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të këtij kodi me ligjin nr.35/2017; në kundërshtim po me këto nene para ndryshimeve me ligjin nr.35/2017 të K. Pr. Penale, të lidhura me udhëzimin nr.241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, të ndryshuar; si dhe në kundërshtim me ligjin e kohës, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, nr. 8737, datë 12.2.2001, i ndryshuar, neni 4, “Ligjshmëria e veprimtarisë” dhe neni 32/b, “shkeljet disiplinore”, në të cilën parashikohen si të tilla edhe “zvarritjet e rënda ose sistematike të procedimeve, ose të detyrave të ngarkuara, ose mospërmbushja e detyrave [...].

19.1.2 Komisioneri Publik, në funksion të këtij ankimi, vlerëson të parashtrijë posaçërisht se në Raport, ndër të tjera, janë referuar, shkeljet procedurale, si vijon:

- **7 materiale kallëzimesh penale** (kallëzimet penale nr. ***/2013, nr. ***/2016, nr. ***/2011, nr. ***/2013, nr. ***/2012, nr. ***/2011 dhe nr. ***/2016), **janë mbajtur në dorë pa veprim, për një periudhë të gjatë, që varion nga 1 deri në 7 vite**, çështje për të cilat prokurorët që u caktuan për ushtrimin e ndjekjes penale, **kanë vendosur mosfillimin e procedimit për shkak se ndjekja penale ishte parashkruar⁷, për shkak të kalimit të afatit.**

- **10 materiale kallëzimesh penale** (nr. ***/2014, nr. ***/2016, nr. ***/2012, nr. ***/2016, nr. ***/2012, nr. ***/2017, nr. ***/2012, nr. ***/2012 dhe nr. ***/2012), **janë mbajtur në dorë pa veprim, për një periudhë të gjatë, që varion nga 1 deri në 6 vite**, kallëzime këto, për të cilat prokurorët që u caktuan për ushtrimin e ndjekjes penale, i kanë regjistruar si procedime penale pas rihedhjes në short në vitin 2018 dhe, në momentin e hartimit të raportit, kanë qenë duke u shqyrtuar.

⁷ Në mënyrë të përsëritur dhe sistematike, subjekti nuk ka respektuar parashikimet ligjore të neneve 291/1, 323 dhe 324, të Kodit të Procedurës Penale (i ndryshuar).

- **10 procedime penale** (nr. ***/2006, nr. ***/2011, nr. ***/2011, nr. ***/2015, nr. ***/2016, nr. ***/2010, nr. ***/2011, nr. ***/2014, nr. ***/2011 dhe nr. ***/2012), **janë mbajtur në dorë pa veprim, për një periudhë të gjatë, që varion nga 1 deri në 7 vite,** çështje për të cilat prokurorët që u caktuan për ushtrimin e ndjekjes penale, **kanë kërkuar miratimin e pushimit të çështjes në gjykatë, për shkak të kalimit të afateve të parashkrimit.**

19.1.3 Po ashtu, referuar *Raportit*, rezulton të jetë parashtruar se: [...] në respekt të nenit 123, pika 3, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendimi për fillimin e hetimit disiplinor iu është njoftuar KLP-së dhe prokurores, znj. Marsida Frashëri. Kjo e fundit nuk ka preferuar të njihet me dosjet konkrete, por, bazuar në të dhënat e përshkruara në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor, ajo thjesht ka prezantuar pretendimet e saj nëpërmjet një “parashtrëse”, nëpërmjet së cilës kërkon mbylljen e hetimit disiplinor me argumentin se, në thelb, janë cenuar parimet e “ligjshmërisë”, të “mosdënimit pa ligj” dhe të sigurisë juridike [...].

19.2 Bazuar në këtë raport, Prokurori i Përgjithshëm, më datë **.4.2019, ka marrë vendim “Mbi mbylljen e hetimit në ngarkim të prokurores Marsida Frashëri, me detyrë prokurore në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër”, duke u verifikuar, ndër të tjera, rrethanat e pamundësisë së fillimit të procedimit disiplinor, në kushtet e mungesës së funksionimit të organit kushtetues kompetent, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

19.3 Referuar këtyre gjeteve të hetimit disiplinor të ushtruar nga Prokurori i Përgjithshëm, gjatë hetimit administrativ, për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nga aktet në dosje, rezulton se Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë **.3.2022, si dhe shkresën nr. *** prot., datë **.3.2022, ka kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër fashikujt penalë për disa nga procedimet penale, për të cilat janë konstatuar shkelje. Komisioni ka konstatuar se, nga përgjigjet e ardhura, ka rezultuar e njëjta situatë ligjore dhe faktike e referuar më lart.

19.4 Në të tilla rrethana, Komisioneri Publik vëren se gjetjet e Komisionit janë të njëjta me ato të referuara në *Raportin* e hartuar nga prokurori përgjegjës për ndjekjen e hetimit disiplinor.

19.5 Komisioneri Publik konstaton, po ashtu, se gjetjet e evidentuara nuk kanë qenë objekt kontestimi as nga vetë subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit disiplinor nga organi kompetent, ashtu as në rezultatet e hetimit gjatë procedurës së rivlerësimit kalimtar⁸. Të njëjtat gjetje të referuara nga grupi i punës në Prokurorinë Shkodër dhe janë konfirmuar dhe nga administrimi fizik i çështjeve, në ecurinë e procedimit disiplinor⁹.

19.6 Referuar vendimit të ndërmjetëm nr.6, nr.577 akti, datë 13.5.2022, konstatohet se Komisioni, në përmbajtje të rezultateve të hetimit, për sa ka administruar, i ka kaluar subjektit barrën e provës, si vijon: [...] (i) Në mënyrë të përsëritur dhe sistematike, subjekti nuk ka respektuar parashikimet ligjore të neneve 291/1, 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale (i ndryshuar), pasi në kallëzimet penale nr. ***/2013, nr. ***/2016, nr. ***/2011, nr. ***/2013,

⁸ Referuar vendimit të ndërmjetëm të Komisionit.

⁹ Në *Raport* referohet se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër, ku i ka ushtruar funksionet prokurorja, znj. Marsida Frashëri, janë kërkuar kopje të dosjeve, tek të cilat janë evidentuar shkelje ligjore, dosje të cilat janë sjellë me shkresën nr. *** prot., datë **.2.2019, dhe janë administruar në Prokurorinë e Përgjithshme, në interes të këtij hetimi disiplinor.

nr. ***/2012, nr. ***/2011 dhe nr. ***/2016 nuk ka bërë veprime hetimore për një periudhë që varion nga 1-7 vite, për të cilat çështja u parashkrua nga prokurorë të tjerë. (ii) Subjekti ka zvarritur për afate të gjata kohore procedimet penale, duke mos kryer asnjë veprim hetimor për kallëzimet penale nr. ***/2014, nr. ***/2016, nr. ***/2012, nr. ***/2016, nr. ***/2012, nr. ***/2017, nr. ***/2012, nr. ***/2012 dhe nr. ***/2012, subjekti nuk ka bërë asnjë veprim për një periudhë 1-6 vite, të cilat janë rihedhur në short nga prokurorë të tjerë në vitin 2018. (iii) Subjekti, në disa në raste, nuk e ka dërguar çështjen për gjykim brenda afateve ligjore. Dy procedime penale (nr. ***/2011 dhe nr. ***/2018 kanë qenë ende nën hetim dhe nuk ka vendim përfundimtar për to). (iv) Në dhjetë procedime penale (nr. ***/2006, nr. ***/2011, nr. ***/2011, nr. ***/2015, nr. ***/2016, nr. ***/2010, nr. ***/2011, nr. ***/2014, nr. ***/2011 dhe nr. ***/2012), subjekti nuk ka kryer veprime hetimore për një periudhë 1-7 vite, për të cilat është kërkuar pushimi i çështjes në gjykatë, pasi janë parashkruar. (v) Tri kallëzime penale janë regjistruar pas hedhjes në short në vitin 2018, kallëzimi penal (nr. ***, datë **.6.2017) ku është kërkuar miratimi i vendimit të pushimit nga prokurori që iu ngarkua, kallëzimi penal (nr. ***, datë **.9.2017) është pezulluar çështja “për moszbulim autori”, si dhe kallëzimi penal (nr. ***, datë **.9.2017) është përfunduar prej një prokurori tjetër. (vi) **Në përfundim të verifikimeve duket se subjekti i rivlerësimit ka treguar neglizhencë të plotë dhe pakujdesi, duke “braktisur” dosjet, kur është larguar nga zyra, duke neglizhuar dorëzimin dhe duke shkaktuar “vdekjen e tyre procedurale” [...].**

19.7 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, është shprehur se [...] Në pozitë e pranimit të kësaj shtate, në vija të përgjithshme të konstatimeve, ju kërkoj të vlerësoni këtë tregues të punës sime në nivel makro, duke e parë atë të lidhur domosdoshmërisht me treguesit e tjerë të veprimtarisë sime profesionale, të cilët, në tërësinë e tyre dhe në shtrirjen e problematikave të theksuara organizative, infrastrukurore dhe funksionale që kanë karakterizuar Sistemin e Prokurorisë në kohën e parareformës, shkrihen në trajtën e një produkti, i cili gëzon vlerat e mirënjohura nga Parimet e Bangalores të Sjelljes së Gjyqësorit, ku integriteti është themelor në përmbushjen e detyrimeve, me gjithë gabimet dhe nevojat për përmirësim, të cilat janë të pashtershme [...].

19.8 Komisioni, për sa më sipër, në vendimin e ndërmjetëm nr.6, nr. 577 akti, datë 13.5.2022, me anë të së cilit ka vendosur pezullimin me afat 1 – vjeçar nga detyra të subjektit dhe detyrimin e ndjekjes së programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] duke çmuar në tërësi problematikat e konstatuara, duke qenë se këto mangësi rezultuan të vazhduara, ndër vite, por në një normë të pranueshme për të mos sjellë pasojën më radikale të shkarkimit nga detyra në raport edhe me ngarkesën në total të punës së saj dhe çështjet e trajtuara, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e plotësimit të këtyre mangësive nëpërmjet një programi trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës [...].

19.9 Ndërsa, në vendimin përfundimtar të procesit të rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit: [...] ka arritur një nivel të kënaqshëm kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale pas përfundimit me sukses të trajnimit njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës, duke mënjanuar mangësitë e konstatuara, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, nenit 59, pika 1 dhe të nenit 60, të ligjit

nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" [...].

20. Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve: (i) referuar kompetencës kushtetuese që e detyron prokurorin të luajë një rol themelor dhe të mbart përgjegjësi të rëndësishme në administrimin e drejtësisë në emër të shoqërisë dhe interesit publik; (ii) duke vlerësuar se veprimet dhe mosveprimet e magjistratit/prokuror në kuadër të ndjekjes penale kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen dhe/ose cenimin e interesit të individëve dhe të Shtetit; (iii) duke mbajtur në konsideratë se besimi i publikut në sistemin e drejtësisë është pazgjidhshmërisht i lidhur me transparencën, efektivitetin, profesionalizmin dhe integritetin e treguar nga magjistratët në ushtrimin e detyrës së tyre, çmon se, gjatë kontrollit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri, ajo ka dështuar të ketë nivelin minimal kualifikues.

20.1 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, sikundër u parashtrua më lart në këtë ankim, Komisioneri Publik vjen në përfundimin se veprimtaria profesionale e subjektit të rivlerësimit, e materializuar në mosveprimet e saj vijuese në shkelje të detyrimeve ligjore, është e shoqëruar dhe vjen si pasojë e njohurive, aftësive, gjykimeve dhe qëndrime të tilla që përfaqësojnë haptazi një model të vepruari aq të dobët, sa kurrsesi nuk pajtohet me pozicionin e saj dhe se mangësitë e thella e të rëndësishme të verifikuara nuk mund të korrigjoheshin përmes programit njëvjeçar të edukimit, e për pasojë, duhet të zbatohet prezumimi në favor i masës disiplinore të shkarkimit sipas nenit E, pika 4 e aneksit të Kushtetutës.

20.2 Subjekti i rivlerësimit, në asnjë rast, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe, për pasojë, duhet të konsiderohet si e papërshtatshme për të ushtruar funksionin e prokurorit, sipas parashikimit të nenit 44, germa "c" e ligjit nr. 84/2016. Për shkak të këtij përfundimi, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke u gjendur në këtë mënyrë në një nga rastet e parashikuara për shkarkimin nga detyra.

20.3 Lidhur me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, pas vlerësimit tërësor të procedurave në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vjen në përfundimin se, për nga rëndësia e tyre, shkeljet e lejuara gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, problematikat e përsëritura e të kthyera në një model pune gjatë viteve të ushtrimit të detyrës, ndikimi në veprimtarinë shtetërore i aktivitetit profesional të subjektit të rivlerësimit, duket se kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për këto shkaqe, duhet të konsiderohet e papërshtatshme për vijueshmërinë e detyrës, edhe në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

21. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale;

22. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në

procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

23. Në të tilla kushte, ku subjekti rezulton me mangësi dhe mospërmbushje të kërkesave të parashikuara në aneksin e Kushtetutës dhe legjislacionin e posaçëm, për kriteret e procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik çmon se, nga vlerësimi tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin konkret duhet të gjejë zbatim neni 61, pikat 4 dhe 5, të këtij ligji;

24. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

25. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 696, datë 11.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsida Frashëri.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA